

Akt Themelimi
i shoqërise me përgjegjësi të kufizuar “ Chimaira ” SHPK

Mbështetur në Kushtetutën dhe Kodin Civil në fuqi të Republikës së Shqipërisë , në Ligjin Nr. 9901 datë 14.04.2008 , “ Për shoqëritë tregëtare” dhe në Ligjin Nr.9723 , datë 03.05.2007 “Për Q.K.R” dhe formalitetet që duhen respektuar nga Shoqëritë Tregëtare , me vullnetin e tyre të lirë , të shprehur edhe në nënshkrimin e këtij akt-themelimi, sot më datë 20 / 01 / 2025 me ortakët :

- 1. Nikollaq Goro i pajisur me ID : H91014041J**
- 2. Dhimitri Koka i pajisur me ID : I80817062W**
- 3. Petro Beleri i pajisur me ID : J40904050D**

krijojmë shoqërinë me përgjegjësi të kufizuar “ Chimaira ” SHPK me akt themelimi si vijon:

Neni 1

Formimi i shoqërisë

Formohet shoqëria tregëtare private e quajtur “ Chimaira ” SHPK. Shoqëria do të nënshtrohet legjislacionit shqiptar , ndërsa degët që mund të krijohen do të nënshtrohen legjislacionit ku do të ketë selinë dega. Shoqëria do të ushtrojë veprimtarinë e saj në bazë të këtij akti themelues dhe statutit të shoqërisë që do të miratohet nga ortakët themelues.

Neni 2

Selia e shoqërisë

- Selia e shoqërisë “ Chimaira ” SHPK do të jetë: Lagjja “Potam”, ZK 1952, Bashkia Himare, Himare. Adresa e shoqërisë për qëllime komunikimi elektronik është si vijon: chimairashpk@gmail.com.

Shoqëria mund të ndryshojë selinë e saj , të hapë zyra përfaqësie , degë , të krijojë filiale si brenda ashtu dhe jashtë Republikës së Shqipërisë , vetëm me vendim të asamblesë së ortakëve.

Neni 3

Objektivi i veprimtarisë

Shoqëria do të zhvillojë veprimtaritë si vijojnë:

- Import dhe tregti e birres dhe dyshekeve.

Neni 4

Kohëzgjatja e shoqërisë

Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë me një afat të pacaktuar . Ajo mund shpërbehet në çdo kohë dhe për çfarëdo lloj shkak.

Neni 5

Kapitali i shoqërisë

Kapitali fillestar i shoqërisë private “ Chimaira ” SHPK do të jetë 1.500.000 (nje million e peseqind mije leke) dhe është i ndarë në aksione në përputhje me ligjin.

1. Ortaku themelues Nikollaq Goro: Zotërues i një kuote që përbën 34 % te kapitalit themeltar të shoqërisë (510 .000 peseqind e dhjete mije leke).
2. Ortaku themelues Dhimitri Koka: Zotërues i një kuote që përbën 33% te kapitalit themeltar të shoqërisë (495.000 katerqind e nentedhjete e pese mije leke).
3. Ortaku themelues Petro Beleri: Zotërues i një kuote që përbën 33 % te kapitalit themeltar të shoqërisë (495.000 katerqind e nentedhjete e pese mije leke).

Neni 6

Drejtimi i shoqërisë

Shoqëria do të drejtohet nga administratori **Z. Nikollaq Goro me ID H91014041J i datelindjes 14.10.1979.** Ai është përfaqësuesi i shoqërisë në marrëdhënie me të tretet dhe ka kompetenca të plota në drejtimin e saj. Cdo kontrate do të kryhet prej saj dhe në rast mungese nga një perfaqesues i pajisur me prokurë të posacme .

Neni 7

Ortakët themelues kanë të drejte të emërojnë dhe administratorë të tjerë të vlerave materiale, kanë të drejtë të caktojnë financierë dhe likuidatorë për problemet e shoqërisë.

Neni 8

Konfliktet që mund të lindin do të zgjidhen në zbatim të legjislacionit Shqiptar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë .

Neni 9

Shoqëria ka vulën e saj me madhësi të zakonshme , me tekstin rreth saj.

Neni 10

Shoqëria deklarohet e krijuar në zbatim të plotë të normave të statutit dhe në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi dhe vecanerisht të Ligjit Nr.9901 datë 14.04.2008 “Për Krijimin e Shoqërive Tregtare” , si dhe duke zbatuar ligjet ndërkombetare dhe të vendit si dhe rregullave që zbatohen për biznesin që kryen kjo shoqëri .

Neni 11

Akti i themelimit u përpilua në 2 kopje , për t’ju shperndare organeve kompetente dhe një kopje do të mbetet në dokumentacionin bazë të shoqërisë “ Chimaira ” SHPK.

Akti i themelimit nënshkruhet rregullisht nga ortakët e saj.


Ortaku i Chimaira SHPK

Petro BELERI



Ortaku i Chimaira SHPK

Nikollaq GORO



Ortaku i Chimaira SHPK

Dhimitri KOKA



chimairashpk@gmail.com